

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË BURIMEVE
NATYRORE DHE MINISTRINË E ENERGJISË DHE INDUSTRIJË
ME OBJEKT “ZHVILLIMIN, MBIKËQYRJEN E SHFRYTËZIMIN RACIONAL TË
BURIMEVE NATYRORE, NË BAZË TË POLITIKAVE QEVERISËSE DHE
MONITORIMIN E POST SHFRYTËZIMIT TË TYRE NË SEKTORIN
HIDROKARBUR”, PËR PERIUDHËN 01.01.2013-30.06.2014.**

Raporti Përfundimtar i Auditimit i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore dhe Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, me objekt “Zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimin racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e post shfrytëzimit të tyre në sektorin hidrokarbur” për periudhën 01.01.2013 deri më 30.06.2014, (por dhe më gjerë, duke u nisur nga vetë natyra komplekse e integrale e operacioneve hidrokarbure e cila kërkon domosdoshmërinë e shtrirjes së periudhës së auditimit që nga çasti i lidhjes së marrëveshjeve juridike me kompanitë që operojnë në këtë sektor), si dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH-së Nr. 57, datë 30.4.2015. Bazuar në nenet 15, 25, 30 dhe 32 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, me shkresat nr. 850/14, datë 06.05.2015 dhe 850/13, datë 06.05.2015, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet përkatëse i janë dërguar përkatësisht z. Damian Gjijkuri, Ministër i Energjisë dhe Industrisë dhe z. Dael Dervishi, Drejtor Ekzekutiv i AKBN, ku janë rekomanduar dhe kërkuar zbatimi i masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI:

1. Nisur nga konstatimi se institucioni i AKBN nuk ka arritur të përmbushi misionin dhe detyrat që i janë përcaktuar me ligj dhe VKM, si dhe në referencë të faktit që për rekomandimet e dhëna nga KLSH me vendim të Kryetarit nr. 502/23, datë 26.09.2014 në referencë të auditimit të ushtruar sipas programit të auditimit nr. 502/1 prot, datë 16.05.2014, me objekt: “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë të aktivitetit ekonomik e financiar dhe mbi objektin e veprimtarisë së AKBN: “zhvillimin, mbikëqyrjen e shfrytëzimit racional të burimeve natyrore, në bazë të politikave qeverisëse, dhe monitorimin e post shfrytëzimit të tyre, në sektorin minerar, hidrokarbur (sektor i cili nuk u mundësua të auditohej) dhe hidroenergjetik”, nga ana e MEI jo vetëm që nuk është bërë asgjë, por është vepruar në drejtim të kundërt duke i dhënë rrugë amendimeve në VKM jo një ndryshimi ligjor të kërkuar nga ne. Kështu pavarësisht se nga AKBN është hartuar një projekt ligj, rrugën për miratim e ka marrë një projekt VKM i hartuar nga AKBN “për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e AKBN”. VKM nr. 930, datë 29.12.2014 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 547 datë 09.8.2006”, i cili konstatohet se është hartuar për ti ardhur përshtat gjendjes në të cilën ndodhej AKBN dhe për ta ligjësuar atë dhe jo për ta ndryshuar atë me qëllim përmirësimin sipas dhe qëllimit të rekomandimeve të dhëna nga KLSH.

Sipas VKM nr. 930, datë 29.12.2014 “Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 547, datë 09.8.2006 mundësohet, që AKBN të përfitojë projekte të financuara nga Buxheti i Shtetit apo nga subjekte të tjera. Nga ana tjetër ndryshimet e fundit ligjërojnë që AKBN të mos i nënshtrohet ligjit për Prokurimin Publik si dhe ligjit për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë. Konstatohet se me VKM megjithëse në titull thuhet se ndryshon VKM nr. 547, realisht bën dhe ndryshimin e VKM nr. 142, datë 12.03.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës

shtetërore dhe institucionet e pavarura”, duke shfuqizuar ndarjen nr. 25. VKM kujdeset që marrëdhëniet e punës së punonjësve të AKBN të rregullohen në bazë të Kodit të Punës, ndryshe nga rekomandimet e KLSH e cila kërkon që të rregullohen nga Statusi i Nëpunësit Civil me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies si dhe mbrojtjes së këtyre punonjësve që operojnë në fusha me risk të lartë duke garantuar përmbushjen sa më të mirë të objektivit të veprimtarisë së këtij institucioni, rekomandim i cili pati parasysh ndryshimet e shumta të ndodhura në staf si dhe në nivelet drejtuese që ka sjellë si pasojë edhe mos përmbushjen e misionit të institucionit dhe nga ana tjetër pamundësi tonën për të ndarë qartë përgjegjësitë individuale për situatën e konstatuar. Kemi konstatuar jo vetëm që rekomandimet e KLSH, nuk janë realizuar por është e dukshme mungesa e dëshirës së Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë për ndryshimin e gjendjes megjithëse situata është bërë prezente nga Raporti Përfundimtar i Auditimit i KLSH, i datës 26.09.2014.

Konstatuam se raporti ekspertë të fushës/staf tjetër nuk mundëson monitorimin dhe kontrollin e plotë të këtyre marrëveshjeve komplekse dhe ndarja jo e qartë e përgjegjësive institucionale në trekëndëshin AKBN, Albpetrol sha dhe MEI kanë çuar në mos mbikëqyrjen e këtij sektori me rëndësi dhe si pasojë dhe keqadministrimin e tij. Ky trekëndësh i cili presupozonte rritjen e instrumenteve të kontrollit shtetëror për të mbajtur në një regjim të fortë sektorin hidrokarbur dhe mbrojtur burimet natyrore nga keqpërdorimi nuk ka arritur të përmbushë objektivin dhe misionin e ngarkuar.

Për sa më sipër është rekomanduar:

a. Nga ana e MEI, në analizë të rezultateve të auditimit të nisi procedurat për inicimin e një nisme ligjore për përcaktimin e statusit dhe rregullimin e veprimtarisë së AKBN-s **me ligj të veçantë dhe jo në VKM** me synimin e garantimit të një pavarësisë institucionale në funksion të rritjes së përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies në përmbushjen e misionit të rëndësishëm që ky institucion ka. Nëse nuk sigurohet pavarësia nga ekzekutivi, element i rëndësishëm për një funksionalitet të plotë dhe përmbushje me sukses e detyrave dhe misioneve të tij, atëherë shumë mirë funksionet mund të kryhen nga një strukturë brenda vetë ministrisë.

E gjykojmë të rëndësishme që në ligj të kërkohej që AKBN, të mos ketë mbështetje financiare nga subjektet private/shtetërore të këtij sektori, duke synuar që financimi të realizohet vetëm nga buxheti i shtetit dhe/ose organizma ndërkombëtarë, fakt që do të eliminonte konfliktin e hapur të interesit të konstatuar rëndom në punën dhe aktivitetin e përditshëm të AKBN-së, por nga ana tjetër do të ndikonte në uljen e shpenzimeve të përfshira si *Cost Recover nga subjektet private* që operojnë në këtë sektor, pasi çdo shpenzim i realizuar në mbështetje të AKBN-së është konsideruar gjithmonë nga ata si kosto për tu rikuperuar.

Në ligj të përcaktohet statusi si institucion publik në varësi të drejtpërdrejtë të **Kuvendit ose Kryeministrit**, si dhe mënyra e funksionimit dhe organizimit, burimi i të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre etj, të cilat në asnjë rast nuk duhet të bien ndesh me kuadrin rregullator ligjor që rregullon veprimtarinë, organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.

Menjëherë.

b. Në referencë të faktit që përmirësimet ligjore siç e theksuam dhe më sipër nuk janë marrë në konsideratë jemi të detyruar që të ri është rekomanduar edhe lidhur me rishikimin e bazës ligjore mbi të cilën funksionon AKBN-ja, veçanërisht në lidhje me monitorimin për realizimin e fuqisë të vendosur të Hec-ve, prodhimin vjetor të energjisë elektrike dhe detyrimin e Fee koncesionare, nga shoqëritë që kanë vënë Hec-et në prodhim, ku AKBN-ja

nuk e përmbush këtë detyrimin ligjor, pasi nga ana e AK kjo kompetencë i është dhënë KESH.

Menjëherë.

2. Nga ana e MEI është propozuar dhe miratuar VKM nr. 947, datë 29.12.2014 e cila bën të mundur që sasinë e naftës që deri dje e përfitonte Albpetrol sha nga Marrëveshjet Hidrokarbure të lidhura me kontraktorët për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese, duke e shitur e shpenzuar për nevojat e saj tashmë do ta përfitoj drejtpërdrejt në para. Pra kompanitë do të paguajnë cash (ekuivalentin e naftës së caktuar) por jo në buxhetin e shtetit por në arkën e Albpetrol sha, pavarësisht se dihet që nafta është një pasuri kombëtare e të ardhurat prej saj duhet të arkëtohen në arkën e shtetit, nga ana tjetër kjo dispozitë bie ndesh me nenin 3 të ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)” i ndryshuar, në të cilën citohet se: *“Të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, që shtrihen brenda juridiksionit të Shqipërisë, duke përfshirë zonat detare, janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar, i cili përfaqësohet nga Ministria përkatëse dhe të gjitha këto burime do të përdoren për dobinë e popullit shqiptar”*.

Për sa më sipër është rekomanduar:

MEI të marrë masat për iniciimin e ndryshimit të VKM nr. 947, datë 29.12.2014, me qëllim që paratë e paguara si ekuivalencë për sasinë e naftës që duhet të përfitonte Albpetrol sha nga Marrëveshjet Hidrokarbure të lidhura me kontraktorët për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese, sipas VKM-së të kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

Menjëherë

3. Nga auditimi u konstatua se marrëveshjet hidrokarbure (MH) dhe licencë marrëveshjet hidrokarbure (LMH) kanë problematika në drejtim të hartimit të tyre, me mungesë të të dhënave teknike gjeologjike, gjeofizike, historike të zonave të kërkimit hidrokarbur ose të zhvillimit hidrokarbur, me referencë në praktika të ndryshme ndërkombëtare (pa i specifikuar ato), mungesë të një oponence të thellë teknike për shkak të mungesës së një institucioni teknik - shkencor për naftën. Këto mungesa, kanë sjellë ndryshime të herë pas hershme të Planeve të Zhvillimit Afatgjatë, të cilat ndikojnë në mënyrë direkte në faktorin R.

Ndërkohë në aspektin juridik konstatohen vakume ligjore, edhe për mungesë të konsulencës juridike shtetërore (nuk ka ekzistuar bashkëpunimi me Avokatin e Shtetit), duke dalë në pah që këto MH kujdesen për të drejtat e kompanive dhe “harrojnë” të drejtat e Shtetit Shqiptar apo dobishmërinë që duhet të përfitojë vendi dhe popullit nga këto pasuri natyrore. Konstatuam se në hartimin dhe miratimin e tyre nuk janë parashikuar penaltetet për mosplotësim të kushteve si nga kompania hidrokarbure e cila do të realizojë kërkimin ose zhvillimin si dhe nga pala shtetërore Albpetrol sh.a, AKBN dhe MEI, por është lënë vetëm me klauzolën “për t’iu drejtuar Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar”.

Për shkak të mungesës së një institucioni teknik - shkencor të pavarur shqiptar të naftës, nuk është bërë e mundur të kemi studime të zonave mbi teknologjinë e prodhimit/kërkimit, të cilat mund të përdreshin paraprakisht duke u saktësuar në këto MH & LMH, pasi mungesa e mos referimit të teknologjisë në MH & LMH, ka sjellë ndryshime të teknologjisë të kërkimit dhe prodhimit në referim të strukturës gjeologjike, e për pasojë probleme monitorimi dhe vlerësimi të aktivitetit të shoqërive të përfshira në këto marrëveshje (kemi parasysht marrëveshjen hidrokarbure Blloku 2-3, licencat për marrëveshje hidrokarbure në vendburimin e Kuçovës, Ballsh-Hekal, Cakran –Mollaj, Patos-Marinza).

Me qëllim realizimin praktik të rritjes së llogaridhënies dhe transparencës së veprimtarisë në këtë sektor të ekonomisë, si dhe për të bërë të mundur mirë administrimin dhe shfrytëzimin

racional të burimeve tona natyrore në sektorin hidrokarbur, është e nevojshme që strukturat shtetërore të mbështeten mbi një ekspertizë teknike, profesionale dhe pse jo dhe shkencore dinjitoze për tu përballur me aspektet teknike të marrëveshjeve dhe proceseve në të cilat përfshihen kompanitë që operojnë aktualisht në vendin tonë. Nga ky fakt si dhe në përputhje me eksperiencat e mëparshme të shtetit apo dhe ato më të mira botërore, **është rekomanduar:**

a. Ringritjen e Institutit Shkencor të Naftës, si një institut i mirëfillt shkencor i cili të mbështesë të gjitha vendimmarrjet e lidhura me zhvillimet e sektorit të hidrokarbureve në vendin tonë si dhe të bashkëpunojë me Kuvendin dhe Qeverinë lidhur me hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjatë të zhvillimeve në këtë sektor duke bërë dhe rolin e oponentit teknik gjatë negociimit të marrëveshjeve, shqyrtimit të propozimeve dhe zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, si dhe orientues dhe oponentë e kërkimeve shkencore që lidhen me burimet hidrokarbure. Ky institucion të funksionojë si një institut i pavarur dhe që mbulon kostot e tij nga buxheti i shtetit dhe projektet e ndryshme të lidhura me sektorin.

Menjëherë

b. Nga ana e MEI dhe AKBN të merren masa që në hartimin e miratimit të marrëveshjeve hidrokarbure të reja të mbështeten, ndër të tjera, në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Avokaturën e Shtetit, duke miratuar marrëveshje tip, në mënyrë që të përfaqësohen denjësisht interesat kombëtare dhe publike, në përshtatje me të dhënat teknike gjeologjike, gjeofizike, historike të zonave të kërkimit hidrokarbur ose të zhvillimit hidrokarbur dhe gjetjen e formateve të marrëveshjeve të tilla që të ardhurat që do të përfitojë buxheti i shtetit të jenë të qarta të matshme dhe lehtësisht të auditueshme.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

4. Nga auditimi u konstatua se MH dhe LHM të tipit marrëveshje me ndarje prodhimi (Production Sharing Agreements), sipas të cilës në fazën e zhvillimit kompanisë i lejohet të përdorë të ardhurat nga nafta për të rikuperuar kostot e operacioneve hidrokarbure të fazës së kërkimit dhe të fazës së zhvillimit, të njohura si kosto të rikthyeshme (Cost Recovery), ajo çfarë mbetet nga këto të ardhura është fitim i cili ndahet sipas përqindjeve të përcaktuara midis kompanisë dhe shtetit. Në rastin kur këto të ardhura nga prodhimi dhe shitja e naftës janë më të vogla se kostot e njohura të rikuperueshme, atëherë Faktori R konsiderohet $R \leq 1$, në rast të kundërt Faktori R konsiderohet $R \geq 1$. Përqindjet që i përkasin kompanisë hidrokarbure dhe qeverisë shqiptare bazohen në ecurinë e faktorit R, i cili sipas marrëveshjes del si rezultat i raportit midis shpenzimeve totale dhe të ardhurave totale. Vetëm në rastet kur Faktori $R \geq 1$, pjesa e mbetur që konsiderohet fitim, ndahet sipas MH në 50 % për kompaninë hidrokarbure me 50% për qeverinë shqiptare.

Vlen të theksohet se në asnjë MH dhe LHM, deri në momentin e hartimit të këtij materiali, nuk është arritur faktori $R \geq 1$. Ndër vite 2009-2014, Faktori R vetëm për MH dhe LHM për vendburimin e Patos-Marinzës në prodhim nga kompania B.P., ka variuar nga 0.7178 në 0.9638 për vitin 2014. Duke u gjendur përpara këtij fakti që $R \leq 1$, Qeveria shqiptare, nga viti 2008 e në vazhdim, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat Kombëtare”, i ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin “Për hidrokarburet”, ka mundësuar implementimin e Rentës Minerare, ku kompanitë e hidrokarbureve në zhvillim paguajnë 10% të shitjeve brenda dhe jashtë vendit në favor të buxhetit të shtetit. *Deri në vitin 2014 (6-mujori 2014) nga kompania B.P., shteti ka përfituar 199 milion USD*, duhet të theksojmë që kjo vlerë që arkëtohet në buxhetin e shtetit është njëkohësisht e njohur për kompaninë si Cost Recovery, që do të thotë këtë vlerë të konvertuar në sasi naftë e ka pronë të saj kompania. Në

dukje krijohet përshtypja që shteti përfiton nga Renta Minerare, por në fakt në raste të tilla kjo ka ndikuar ndër vite, në mos arrijen e Faktorit $R \geq 1$, gjë do të sillte të ardhura të tjera shumë më të larta për shtetin shqiptar e të pa ngarkuar me Cost Recovery.

Gjatë auditimit është vërejtur se, kemi disa miratime dhe ndryshime në lidhje me Planet Zhvillimit Afatgjata, të cilat nuk janë bërë për përmirësimin e MH në raport me pozitën e shtetit shqiptar, të cilat nuk kanë ndikuar në arrijen e Faktorit $R \geq 1$, por në të kundërt. *Këto ndryshime janë miratuar ndër vite nga të gjitha strukturat e shtetit në nivel qendror*. Si pasojë e këtyre ndryshimeve të Planeve të Zhvillimit kohë mbas kohe, treguesit ekonomik – financiar të arritur nga veprimtaritë e kompanive hidrokarbure kanë pasur mospërputhje, krahasuar me parashikimet e miratuara në Planet Afatgjatë të Zhvillimit (PZH), Planet dhe Buxhetet e Punës vjetore (PP&B), duke raportuar të kryera me tejkalim shpenzimet, krahasuar me naftën e nxjerrë, pavarësisht se me rritje, duke iu përfaqësuar Faktori $R=1$, por duke mos e arritur asnjëherë. Ky rast është vetëm për MH dhe LHM për vendburimin e Patos-Marinzës në prodhim nga kompania B.P., ndërsa për kompanitë e tjera hidrokarbure Faktori R është shumë i ulët. Me qëllim që Faktori R të jete real, kërkohet që dhe shpenzimet e rikuperueshme të jenë reale, gjë e cila kërkon dhe sigurohet nga një auditim kompetent profesional, me integritet, në kohë si dhe një monitorim perfekt i të gjitha proceseve hidrokarbure që zhvillohen nga kompanitë e që njihen si Costo Recovery. Pikërisht në këtë pikë institucionet shtetërore kanë dështuar, kjo e trajtuar dhe Raportin Përfundimtar të Auditimit si dhe në Vendimin 528/25 datë 24.09.2014, dërguar me shkresën nr. 528/29, datë 26.09.2014 në MEI dhe dërguar në Albpetrol sh.a me shkresën nr. 528/30, datë 27.09.2014.

Në referencë të termave kohore të kontratave respektive ku përcaktohen afatet për të ushtruar të drejtën për auditim, AKBN e kryen (brenda 3 viteve nga dorëzimi i pasqyrave financiare për atë vit (për prodhimin) dhe brenda 3 muajve nga dorëzimi i raportit të kostove të rikuperueshme 3 mujore, për kërkimin). Konstatohet, se AKBN, nuk mund të mbulojë në kohë të njëpasnjëshme vjetore auditimet tekniko-ekonomike të këtyre kompanive hidrokarbure. Kjo mospërputhje në kohë, nga ndodhja e veprimit deri në auditim nga AKBN, është e mbështetur në MH dhe LM, por kjo nuk i pengon strukturat e shtetit shqiptar, të gjejnë mundësinë me burimet njerëzore dhe profesionale, të realizojnë këto auditime tekniko-financiare në kohë duke qenë koherente me deklarinimin e bilanceve financiare vjetore nga ana e kompanive hidrokarbure, në bashkëpunim me institucione të specializuara siç mund të jetë edhe një Institut Shkencor Naftë, siç propozohet nga ne më sipër.

Përgjatë auditimit konstatohet se strukturat shtetërore MEI, AKBN dhe Albpetrol sh.a, kanë qenë pothuaj inekzistente, në drejtim të monitorimit të të gjithave operacioneve teknike, konform planeve të miratuara dhe të rezultateve financiare të lidhura me aktivitetin hidrokarbur. Ato janë mjaftuar vetëm me vëzhgimin vizual, sporadik pa u orientuar në kontrollin ligjor, financiar dhe tekniko-shkencor të implementimit të kësaj marrëveshje. Është e kuptueshme që Faktori R nuk mund të dalë asnjëherë i barabartë me 1 dhe për më tepër më i madh se 1, në rast se këto institucione nuk ushtrojnë funksionet që ju jep ligji, sidomos të lidhura me monitorimin dhe auditimin ligjor dhe financiar si garanci e vërtetësisë së shpenzimeve të kryera (aq më tepër që ky vendburim i Patos Marinzës, konsiderohet në fazën shteruese, fazë Depliti).

Për sa më sipër është rekomanduar:

a. Në varësi të ndryshimeve ligjore e strukturore të rekomanduara nga ana jonë përfshirë dhe rikrijimin e Institutit të Naftës, nga ana e Strukturave përgjegjëse të parashikohen nevojat për burimet njerëzore profesionale dhe të plotësohen ato me qëllim realizimin e auditimeve brenda afateve sa me të shkurtra nga dorëzimi i pasqyrave financiare për atë vit (për prodhimin) dhe brenda 3 muajve nga dorëzimi i raportit të kostove të rikuperueshme 3 mujore (për ato marrëveshje që janë në fazë kërkimi).

Menjëherë e vazhdimisht

b. Nga ana e MEI dhe AKBN, të merren masa për të vendosur instrumente monitorimi të efektshme dhe të kërkojë rivlerësimin objektiv të planeve të zhvillimit, operacioneve teknike dhe auditime financiare profesionale dhe të pavarura lidhur me kostot reale që përfshihen në aktivitetin hidrokarbur, për ti vënë në efikasitet marrëveshjet e lidhura, me qëllim të një vlerësimi të saktë të Faktorit R, me synim mos shmangien e detyrimeve financiare ndaj shtetit. Në çdo rast të përcaktohet niveli i përgjegjësisë së individëve të përfshirë në këtë proces në mënyrë që ti prihet rruga formalitetit të këtyre monitorimeve ku interesat e shtetit shihen të fundit.

Menjëherë

c. Nisur nga konstatimi se mënyra e organizimit dhe funksionimit të Drejtorisë Hidrokarbure brenda AKBN, krijonte pamundësi për të realizuar misionet mbikëqyrëse, nga AKBN të merren masat për ristrukturimin e kësaj Drejtorie me struktura të cilat jo vetëm t'i kenë detyrat e mirë përcaktuara, përgjegjësitë konkrete por dhe të mundshme për tu realizuar. Nga AKBN të merren masat për hartimin e miratimin e rregulloreve specifike procedurale që të përcaktojnë dhe rregullojnë procedurat operacionale të punës së Drejtorisë Hidrokarbure pranë AKBN në drejtim të mbikëqyrjes dhe monitorimit.

Menjëherë

5. Nga auditimi rezultoi se në zonën e Patos - Marinzës ku ushtron aktivitetin Kompania B.P.. mbetjet nga procesi i nxjerrjes së naftës nuk janë në gjendje të ngurtë si procesi fundor i përpunimit të tyre. Aktualisht janë 8 (tetë) gropa ekologjike (Ekopite), në brendësi të tyre ekzistojnë përmbajtje solide dhe kokrrizat e rërës, të cilat janë nxjerrë nga shtresat naftëmbajtëse. Sasia e rërës së nxjerrë nga shtresa kap shifrën 103520 m³. Duke pasur parasysh sasinë e naftës së nxjerrë gjatë vitit 2014 (1 229 272 m³) sasia e rërës së nxjerrë dhe të depozituar në këto Ekopite do të ketë shifrën minimale prej 4% të kësaj sasive ose 49 170 m³. Nga mbledhja e të dy shifrave sasia e rërës rezulton 152 690 m³, po të ekuivalentojmë do të ishte e barabartë me një shtresë ranore me sipërfaqe 15.269 ha me trashësi 1 m, ose 152.69 ha me trashësi 10 cm. Në qoftë se këtë argument e shtrijmë në kohën e ushtrimit të Marrëveshjes Hidrokarbure dhe për rezervat e naftës që do të shfrytëzohen nga kompania B.P., vendburimi Patos – Marinëz, në të ardhmen, atëherë zona do të kthehet në një kënetë Ekologjike, që për rehabilitimin e saj nuk do të mjaftojnë 50 milion USD, sikurse e kanë planifikuar në fund të fazës së abandonimit, por shumë herë më tepër.

Një dëm tjetër i parikuperueshëm me pasoja subsidence (fundosje) të sipërfaqes do të ndodhë për shkak të prishjes së ekuilibrit të forcave të brendshme në njësinë e kolektorit. Një rezervuar i ndodhur në një thellësi me mijëra feet është objekt i një ngarkese presioni i shkaktuar nga pesha e mbivendosjeve të formacioneve. Presionet për efekt ngarkese ndryshojnë nga sipërfaqja në sipërfaqe që varet nga faktorët të tillë si thellësia, natyra e strukturës, konsolidimi i formacionit, dhe mosha gjeologjike e mundshme dhe historia e shkëmbit. Këto tregues shfrytëzimi të zonës rrisin ndjeshëm mundësinë e ndodhjes së një subsidence (fundosje) të sipërfaqes së tokës në zonën përkatëse, e shoqëruar në vazhdimësi me lëkundje sizmike. **Kjo është e sigurt nga ana shkencore ku nuk shtrohet pyetja: A do të ndodhë? Por, kur do të ndodhë? E shprehur kjo dhe në Projektraportin e Auditimit të KLSH të datës 09.03.2015, pra përpara ngjarjes së fundit të muajit Prill të ndodhura në këtë zonë.** Këto konkluzione duhej të ishin të evidentuara nga AKBN, Albpetrol sha. dhe MEI me qëllim marrjen e masave për ndryshimin e gjendjes. Por kjo gjykojmë se ka ardhur

nga shterimi i vazhdueshëm në kohë i elementit ekspert në fushën e naftës, nga këto struktura që kanë detyrë pikërisht të mbulojnë me ekspertizë proceset e mbi tokës e nëntokës sidomos për sa i përket mirë shfrytëzimit e burimeve natyrore. Tregues i të cilës është dhe mosmiratimi akoma nga ana e MEI i “Rregullores së ruajtjes së nëntokës” megjithëse nga ana e shtetit janë shpenzuar fonde publike për këtë qëllim që nga viti 2003 e në vazhdim.

Për sa më sipër është rekomanduar:

a. Nga ana e MEI, të merren masa për miratimin e Rregullores së aktivitetit të kërkimit e zhvillimit të naftës dhe gazit në Shqipëri për ruajtjen së nëntokës, duke reflektuar në të opinionin teknik e shkencor dhe vizionet e reja politike të qeverisë për mirëmenaxhimin e aktivitetit hidrokarbur.

Menjëherë

b. Nga ana e MEI, pas studimit të gjendjes së krijuar në vendburimin e Patos - Marinzës, të merren të gjitha masat e mundshme duke iniciuar ndryshimet ligjore dhe sigurimin e fondeve të nevojshme, në bashkëpunim me institucionet e tjera përgjegjëse të shtetit, me qëllim për të mundësuar zhvendosjen e përhershme të banorëve të cilët kanë vendbanimet në këto zona, përmes mbështetjes së plotë financiare nga kompanitë e naftës, Albpetroli pse jo dhe qeveria shqiptare.

Menjëherë

6. Meqenëse konstatohet se nuk ekziston një përllogaritje e depozitimeve hidrokarbure që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë, që shtrihen brenda juridiksionit të Shqipërisë, duke përfshirë zonat detare, duke qenë se janë pronë ekskluzive e shtetit shqiptar, bazuar në nenin 3 të ligjit nr. 7746, datë 28.07.1993 “Për hidrokarburet kërkimi dhe prodhimi” i ndryshuar. Me qëllim që të gjitha këto burime të përdoren për dobinë e popullit shqiptar që në fazën e para lidhjes së Marrëveshjeve Hidrokarbure.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Të merren masat ligjore e organizative nga MEI së bashku me Albpetrol sha. dhe AKBN duke mbajtur bashkëpunim me institucionet shkencore, si Fakulteti i Gjeologji Minierave, për llogaritjen dhe regjistrimin e përditësimin e depozitimeve hidrokarbure që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë duke krijuar një database të administruar nga MEI, ndërkohë që duhet të ngrihet Instituti Shkencor i Naftës, i cili duhet të luajë më pas rolin kryesor në këtë drejtim.

Menjëherë e vazhdimisht

B. MASA ORGANIZATIVE

KLSH gjykon se, rekomandimet për masa organizative të vendosura në këtë pikë janë të karakterit emergjent. Ato kanë vlerë vetëm kur ato do të kombinohen me fillimin e menjëhershëm të punës nga ana e MEI dhe institucioneve më të larta të shtetit si Kuvendi e Kryeministria, për hartimin e miratimin e ndryshimeve ligjore të propozuara nga ana jonë. Këto masa organizative do të shërbejnë, për përmirësimin e gjendjes në institucionet shtetërore që operojnë në sektorin hidrokarbur por ato nuk garantojnë qëndrueshmëri për sa kohë që nuk shoqërohen domosdoshmërisht me ndryshimet e nevojshme strukturore e organizative të institucioneve. Institucione këto të cilat janë ngarkuar sipas ligjit të përfaqësojnë palën shtetërore që ka detyrë e përgjegjësinë për mirëadministrimin e kësaj pasurie publike siç është dhe sektori hidrokarbur. Për sa më sipër këto masa organizative nga ana e KLSH nuk janë shteruese por që gjykohen të domosdoshme për kohën.

1. Nga auditimi u konstatua se në mars 2011, B.P. ka nënshkruar marrëveshje për financimin e zhvillimit të vendburimit të Patos-Marinzës, për një vlerë 110 milion USD me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe International Finance Corporation (IFC), ku një pjesë e këtij kreditimi, rreth 10 milion USD, do të përdoren për rehabilitimin e mjedisit. Gjithashtu B.P. ka marrë edhe nga R B një kredi prej 30 milion USD, më datë 30.06.2008 për të financuar Planin e Zhvillimit. Gjatë vitit 2013 kompania ka vazhduar punën për të zbatuar “Plan Veprimi Social Mjedisor” siç është rënë dakord me IFC dhe BERZH, në të cilin pasqyrohen drejtimit kryesore të punës që priten të arrihen gjatë Programit Vjetor të vitit 2015, për rehabilitimin dhe përmirësimin e tokës nëpërmjet ngritjes së impiantit të përpunimit të llumrave, menaxhimit të mbetjeve si dhe monitorimit të ndikimit në mjedis. Rehabilitimi i mjedisit parashikon ndërtimin dhe trajtimin e Gropave Ekologjike 1&2, përpunimin e dherave dhe llumrave të ndotur që krijohen nga prodhimi, pastrimi e rehabilitimi i puseve e shesheve ku kryhen operacione dhe rehabilitimi i dherave të ndotur në rreth 200 sheshe të ndotura. U konstatua se për të mundësuar këto hua, B.P., ka transferuar interesat e kësaj Marrëveshjes Hidrokarbure tek këto banka, në kundërshtim të plotë si me Marrëveshjen Hidrokarbure dhe bazën ligjore që operon në fushën hidrokarbure.

Për sa më sipër është rekomanduar:

- a. Nga ana e AKBN, të shqyrtohen me kujdes marrëveshjet e huas në të cilat implikohet transferimi i interesave të Marrëveshjeve Hidrokarbure (listën e aseteve të vendburimit Patos-Marinzës të lënë si kolateral), efektet që kanë këto marrëveshje huaje në të ardhmen dhe risqet me të cilat mund të përballet shteti në rastin e mungesës së likuiditetit apo pamundësisë paguese të kompanisë, vlerësimi i procedurës së ndjekur për të marrë miratimin në kushtet kur ka vepruar në kundërshtim të plotë si me Marrëveshjen Hidrokarbure dhe bazën ligjore që operon në fushën hidrokarbure.
- b. Në këtë proces vlerësimi sa kompleks dhe delikat AKBN dhe MEI, të bashkëpunojë ngushtë me Avokatin e Shtetit duke analizuar çdo risk të aspektit juridik që cenon interesat e shtetit shqiptar, si dhe me çdo institucion tjetër shtetëror që do të ndihmonte në saktësimin edhe të risqeve financiare të mëvonshme.

Menjëherë

2. Nisur nga shqetësimi mediatik i banorëve të Komunës Zharrës të rrethit Fier, grupi i auditimit të KLSH auditori mbi fenomenin e lëkundje të tokës në këtë zonë, si pasojë e të cilës janë shkaktuar dëme në banesat e tyre. Nga auditimi u konstatua se B.P. me datë 09.01.2012 ka lidhur një kontratë shërbimi me kompaninë S. Kjo kompani si operator me përvojë globale në fushën e rritjes së prodhimit të naftës ka ofruar një gamë të gjerë të shërbimeve dhe të ndërhyrjes për të rritur prodhimin e puseve si edhe me përmirësimin e performancës duke siguruar vendosjen në efikasitet të rezervave të naftës të bllokuara të natyrës litologjike (shtresëzimet) ose të rritjes së përshkueshmërisë të zonës së drenimit të puseve. S, duke qenë e pajisur me Coil Tubing (pajisje speciale) ka kryer një sërë operacione hidrokarbure sikurse ka qenë, pastrimi i zonës ballore të puseve horizontal, proceseve të perforimit të sektorit prodhues, si edhe kryerjen e çarjeve hidraulike. Ajo ka një teknologji të avancuar për këto procese si dhe shërbime mikrosizmike për të kontrolluar lëkundjet që shoqërojnë çdo operacion hidrokarbur. Ky proces i përshkruar është dyshues, në krijimin e valëve lëkundëse, mbasi vrimat e shkaktuara nëpërmjet këtyre valëve shpërthyese, siguron rrjedhje të fluidit nga shtresa në fund të pusit. Lidhur me këtë kontratë shërbimi, AKBN dhe Albpetrol sh.a nuk kanë bërë monitorime në operacionet e perforimit dhe çarjeve hidraulike, identifikimin nëpërmjet regjistrimeve të lëkundjeve sizmike, me qëllim që të jenë brenda normave

(lëkundjet që shkaktohen), për të mos dëmtuar komunitetin që ndodhet në rrezen e veprimit të këtyre operacioneve hidrokarbure. ***Këto fakte janë cilësuar që në Projekt Raportin e Auditimit përcjellë në subjekt në datën 10.03.2015.***

Për sa më sipër është rekomanduar:

a. MEI dhe AKBN, të vlerësojë dhe kontrollojë proceset teknologjike të realizuara nën kontratën e shërbimit me kompaninë S, përcaktojë nivelin e dëmit të shkaktuar për popullatën e Komunës Zharrës të rrethit Fier dhe të nxjerrin përgjegjësitë në lidhje me dëmshpërblimin e dëmeve të cilat kanë ardhur si pasojë e proceseve të performimit të sektorit prodhues dhe çarjeve hidraulike por pa harruar dëmin në drejtim të prishjes së strukturës së shtresave, nga shfrytëzimi pa asnjë lloj kriteri hidrodinamik, që është në kundërshtim të plotë me çdo normë të ruajtjes së nëntokës, dhe përdorimi i metodave shpërthyes, kategorikisht të ndaluar të zbatohen në vendburimet terigjene (vendburime ranore) për të rritur komunikimin shtresë-pus.

b. Të nxirren përgjegjësitë institucionale, për veprimet dhe mos veprimet lidhur me monitorimin e operacioneve të zhvilluar nga kompania B.P. nëpërmjet kompanisë S si dhe për mos marrje masash për identifikimin e problemeve të krijuara nga lëkundjet dhe arsyet e tyre duke sjellë rritjen e përmasave të këtij dëmi, shqetësimin popullor.

Menjëherë

3. Nga auditimi i marrëveshjes dhe licencë marrëveshjes hidrokarbure për vendburimin Kuçovë u konstatua se sipas përcaktimit në Marrëveshje, Faza e Vlerësimit ka filluar më datë 02.11.2007 deri 02.11.2009, fazë në të cilën ishin parashikuar të kryheshin operacione hidrokarbure që kanë të bëjnë me studimin, rivlerësimin dhe certifikimin e rezervave të naftës, përcaktimin e skemës teknologjike të shfrytëzimit të vendburimit, si dhe përcaktimin dhe testimin e metodave të ndryshme intensifikuese për rritjen e performancës së rezervuarit naftëmbajtës, etj. Në shtator të vitit 2008 kompania B.P, u bë pronare e vetme e kompanisë Sh I dhe del në përfundim se teknologjia e nxjerrjes së naftës, e parashikuar në marrëveshjen e mëparshme, me metodën CHOP (Cold Heavy Oil Production), me pompa me burmë (PCP) nuk rezulton efektive, pasi kemi të bëjmë me naftë jo viskoze, dhe se metoda më e përshtatshme për nxjerrjen e naftës në këtë vendburim është ajo me pompë thellësie duke aplikuar njëkohësisht injektimim e ujit për ruajtjen e presionit të shtresës. Ky ndryshim domosdoshmërisht kërkoi edhe amendimin e Licensës dhe Marrëveshjes Hidrokarbure.

Nga dokumentacioni në dosje, konstatuam vonesa procedurale për paraqitjen e vizionit të kompanisë për zhvillimin e mëtejshëm të vendburimit të Kuçovës, e deri në fund të dhjetorit 2014 nuk ka një vizion të qartë për mënyrën dhe teknologjinë e shfrytëzimit të vendburimit të Kuçovës. Nga ana tjetër pavarësisht se kjo marrëveshje, është në vitin e shtatë të saj dhe në vitin e katërt të periudhës së zhvillimit dhe prodhimit, konstatohet se *ende ky vendburim nuk është dorëzuar në mënyrë integrale nga Albpetroli sh.a, duke cenuar kështu preambulën e LM të miratuar ku thuhet se “Qeveria Shqiptare dëshiron që rezervat e naftës dhe gazit që shtrihen në zonën e kontratës të shfrytëzohen në mënyrë racionale, në përputhje me praktikën përgjithësisht të pranuar në industrinë e naftës”.*

Për sa më sipër është rekomanduar:

a. MEI në bashkëpunim me Albpetroli sh.a, të veprojë me shpejtësi për të vënë në efikasitet këtë vendburim në mënyrë që të sigurohet mbledhja e të ardhurave nga pasuria e vënë në shfrytëzim duke filluar me dorëzimin e këtij vendburimi.

b. MEI të analizojë me kujdes përgjegjësinë e çdo instance apo individit që kanë sjellë problematikën e mësipërme duke e lënë këtë zonë me të pa zhvilluar, dhe duke sjellë si

pasojë mungesën e të ardhurave për buxhetin e shtetit minimalisht të vlerës së Rentës minerare.

Menjëherë

4. Nga auditimi i kontratës me ndarje prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Shqipëri në tokë, Blloqet 2-3, konstatohet se në këto blloqe (rreth 200 m larg nga pusi Shpiragu 2) ka ushtruar kërkimin e naftës kompania amerikane O (sipas MH të miratuar me VKM nr. 360 datë 21.09.1991) e cila shpoi pusin Shpiragu 1 dhe pasi deklaroi naftë u largua nga Shqipëria duke marrë me vete një faturë prej rreth 80 milion USD. Me VKM nr. 754, datë 08.07.2009 është lidhur kontrata me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në blloqet 2,3 me D P.

Gjatë fazës së parë të kërkimit, Kompania P, ka shpuar pusin Shpiragu-2 duke arritur thellësinë finale 5553 m. Me shkresën nr. 755 datë 13.12.2013 drejtuar AKBN, Kompania P ka deklaruar se ka bërë zbulim në pusin Shpiragu-2. Nga ana tjetër një vlerësim i pusit që është duke u shpuar në zonën e Molisht-1 dhe një pus shtesë që do të shpohet në zonën e zbulimit Shpirag-3, do të ndikojë në rezultatet e favorshme të Pusit të vlerësimit, dhe të përcaktojë nëse Zbulimi Shpirag -2 është i denjë për një zhvillim komercial. Pra, shpimi i pusit Molisht-1 konsiderohet në zonën e zbulimit. Bazuar në skemën strukturore dhe profilet gjeologo – gjeofizik përkatës të këtij vargu gjeo-strukturore kuptojmë se, struktura Molisht përfaqëson një strukturë më vete e ndarë e individualizuar me tektonike e thellësi tjetër. Kjo bënë të kuptosh nga ana shkencore, se pusi Molisht- 1 nuk është pjesë së strukturës së zhvillimit perspektiv të zonës së zhvillimit Shpiragu-2, por mund të jetë vetëm zonë e re kërkimore. Referuar Programit vlerësimit: Zona zbulimit, hapat e hedhura në vlerësimin e rezervuarit, duke shpuar Shpiragun-1, me tej Shpiragun-2 janë në përputhje me metodologjinë e kërkimit dhe të vlerësimit, ndërsa kalimi tek shpimi i pusit Molisht-1 është në kundërshtim të plotë me metodologjinë e vlerësimit dhe të konturimit, mbasi distanca e projektimit të pusit të konturimit nuk duhet t'i kaloj katër rreze konturi. Meqenëse nga auditimi konstatohet se statusi i pusit Molisht 1 nuk është i qartë (ndryshe nga sa pretendohet nga AKBN) nëse është një pus kërkimi apo një pus vlerësimi, trajtuar më hollësisht në pikën VI të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Nga MEI dhe AKBN të vlerësohen me kujdes të gjitha faktet, dokumentet e sjella në vëmendje nga grupi jonë i auditimit dhe bazuar në një ekspertizë të kujdesshme teknike, profesionale dhe të pavarur të merren masat e nevojshme që të pranohet nga kompania P statusi i pusit Molisht 1 si pus kërkimi si dhe të monitorohen të gjitha kostot e lidhura me puset Shpiragu 1 dhe 2 në mënyrë që të mos ketë kosto të rritura padrejtësisht që do të jepen efekte në rezultatet financiare të kësaj marrëveshje hidrokarbure.

Menjëherë

5. Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) lidhur me procedurat dhe rregullshmërinë e përjashtimeve nga TVSH për shërbimet e kryera sipas kontratave për llogari të kompanive që veprojnë në sektorin e hidrokarbureve, ka rezultuar se jo vetëm këtyre kompanive por dhe nënkontraktorëve të tyre u është dhënë e drejta e përjashtimit nga tatimi mbi vlerën e shtuar për të gjitha aktivitetet pavarësisht faktit nëse kanë lidhje shkakësore direkt ose indirekt me operacionet hidrokarbure. Nga ana auditimi konstatohet se procedura e konfirmimit të këtyre përjashtimeve ndodh shumë kohë më vonë se kërkesa për deklarimin e librave të TVSH pranë organeve tatimore që nënkupton se procedura e konfirmimit realizohet formalisht (pra deklarimi “i përjashtuar” është bërë nga kompania dhe AKBN vetëm konfirmon këtë deklaram). Kështu gjykojmë se B.P ka përfituar

padrejtësisht përjashtim TVSH në masën 235 milionë lekë për furnizimet e kryera, S G ka përfituar padrejtësisht përjashtim TVSH në masën 28 milionë lekë për furnizimet e kryera, P ka përfituar padrejtësisht përjashtim TVSH në masën 30 milionë lekë për furnizimet e kryera, T sha ka përfituar padrejtësisht përjashtim TVSH në masën 4 milionë lekë për furnizimet e kryera, C A ka përfituar padrejtësisht përjashtim TVSH në masën 13 milionë lekë për furnizimet e kryera si dhe S D ka përfituar padrejtësisht përjashtim TVSH në masën 4 milionë lekë për furnizimet e kryera duke krijuar mundësinë për nënkontraktorët e tyre që të shmangin pagesën e TVSH (32 nënkontraktorë), *trajtuar më hollësisht në pikën XI të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.*

Për sa më sipër është rekomanduar:

a. AKBN në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të ndjekë procedurën e vlerësimit të shërbimit të përjashtuar që në fazën e lidhjes së kontratës me këto nënkontraktorë dhe më pas përgjegjësia e trajtimit fiskal dhe kontabël mbetet tek kompania që përfshihet në një marrëveshje hidrokarbure, kjo do të eliminonte jo vetëm formalitetin por edhe impenjimin e madh njerëzor dhe kohor që kërkon ndjekja dhe vlerësimi i çdo fature në kohë reale. Kërkohet një rol me aktiv i organeve tatimore në mënyrë që kontrolli të jetë sa më efektiv dhe të arrihet të bëhet në kohë sa më reale.

b. Nisur nga vlera e përjashtimit dhe faktit që këto shërbime janë përfshirë jo në mënyrë të drejtë në operacione hidrokarbure duke pasur efekt edhe në vlerën e Faktorit R, i kërkojmë AKBN-së, të rishikojë me përgjegjshmëri të lartë miratimet e lëshuara të paktën për efekte të llogaritjes së Faktorit R për kompanitë e specifikuar më lartë, duke argumentuar gjithmonë pse shërbimet e ofruar nga nënkontraktori përbëjnë operacion hidrokarbur dhe së në cilën fazë të kërkimit apo zhvillimit janë të domosdoshme këto operacione hidrokarbure për të cilat i kërkohet AKBN vërtetimi duke vepruar me vendime unifikuese dhe duke pasur të njëjtin qëndrim për operacione/furnizime të së njëjtës natyrë. Të synohet që të bëhen kontrolle efektive të shoqëruara me një proces rivlerësimi të vlerës së Faktorit R për të gjithë vitet në të cilat shtrihen marrëveshjet.

Menjëherë

6. Nga auditimi i Marrëveshjes Hidrokarbure, për Blloqet 2, 3 dhe 4 në det, miratuar me VKM nr. 383, datë 06.06.2012, u konstatua se nga momenti i hyrjes në fuqi, kjo marrëveshje nuk ka qenë asnjëherë plotësisht efektive dhe kompania EAE nuk ka qenë e aftë të përmbushë detyrimet kryesore që rrjedhin nga MH-ja. Mungon depozitimi për llogari të AKBN-së të Garancisë Bankare të fazës së parë të kërkimit. Moskonfirmimi i lëshimit të garancisë, në kushtet kur faza e parë e kërkimit për këtë marrëveshje ka mbaruar më datë 14.12.2014 dhe kompania EAE nuk ka mundur të përmbushë detyrimet që parashikon kjo fazë, vlera 3 milionë dollarë quhet e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit.

Mbi auditimin e Kontratës me Ndarje Prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Shqipëri, Bllokun Joni – 5 në det, miratuar më VKM nr. 507, datë 08.08.2007, u konstatua se nga momenti i hyrjes në fuqi kjo marrëveshje ka pasur disa kalime pronësie dhe interesash, por rezulton se nuk ka në AKBN gjurmë të një miratimi paraprak për këto kalime në kundërshtim me kërkesat e MH. Nga auditimi i praktikës së ndjekur në lidhje me këtë marrëveshje, vihet re një mungesë vëmendjeje dhe profesionalizmi nga stafi përgjegjës në vite të AKBN-së për kontrollin dhe mbikëqyrjen e ecurisë së kësaj marrëveshjeje që prej fillimeve të saj. Aktualisht kjo marrëveshje është e bllokuar dhe nisur nga ecuria mund të themi edhe e dështuar.

Nga auditimi i Marrëveshjes me Ndarje Prodhimi për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve në Shqipëri, Bllokun Durrësi 5 në det, miratuar me VKM nr. 562, datë 27.08.2004, rezulton se marrëveshja ka pësuar dy amendime për shkak të mos arritjes së përmbushjes së detyrimeve të saj duke shtuar edhe detyrimet për një nivel më të lartë investimi dhe shpim edhe të dy puseve. Në përfundim të auditimit të dosjes së ecurisë së kësaj MH-je nuk ka gjurmë të fillimit të përmbushjes së detyrimit të shpimit të dy puseve në vlerën minimale të përcaktuar si investim pavarësisht se afati i përcaktuar për përfundimin e fazës kërkimore të MH-së është 30.07.2015.

Nisur nga konstatimet e mësipërme, problematikave të ndryshme të marrëveshjeve të audituara por që të çonin në një konkluzion të vetëm që marrëveshjet ishin jo efektive për të mos thënë të dështuara dhe kompanitë ishin duke vepruar në shkelje të kushteve të MH për shkak të mungesës së profesionalizmit teknik dhe financiar dhe apati të institucioneve që ngarkohen me ligj të mbikëqyrin ecurinë e këtyre marrëveshje **për sa më sipër është rekomanduar:**

Nga AKBN dhe MEI të bëhet një vlerësim i kujdesshëm i të gjithë kushteve të marrëveshjeve të lidhura për kërkimin e hidrokarbureve në det dhe të kërkohet me kosto sa më të ulët për shtetin shqiptar rinegociimi i këtyre marrëveshjeve me partner strategjikë dhe seriozë që do të çonte në vënien e plotë në efikasitet të marrëveshjeve por dhe rritjes së profesionalizmit në trajtimin e burimeve tona natyrore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë

7. Meqenëse nga auditimi u konstatua se disa punonjës të AKBN kanë përfituar shpenzime për dieta ndërkohë që janë trajtuar njëkohësisht me trajtim ushqimor dhe akomodim si dhe transport nga kompanitë hidrokarbure duke u llogaritur këto si kosto të rikuperueshme nga ana e tyre.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Nga ana e AKBN të merren masat për arkëtimin e shumave të përfituara padrejtësisht nga personat përfitues ose nga personat të cilat kanë autorizuar apo paguar këto dieta.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Nisur nga konstatimi i jonë se Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN) i ka dhënë përjashtimin e TVSH për furnizimet jo vetëm këtyre kompanive por dhe nënkontraktorëve të tyre, si dhe faktit që kanë marrë miratimin për përjashtim **në mënyrë të parregullt në rreth 316 milionë lekë** pasi nuk është argumentuar arsyeja pse shërbimet e ofruar nga nënkontraktori janë operacione hidrokarbure, paraqitur këto sipas tabelave të mëposhtme:

a. Për nënkontraktorët e B.P.:

	<i>Nënkontraktorët</i>	<i>TVSH e përjashtuar (shprehur në lekë)</i>
1	<i>F shpk</i>	<i>699.000</i>
2	<i>F shpk</i>	<i>2.117.100</i>
3	<i>A</i>	<i>10.069.730</i>

4	GR shpk	310.000
5	G shpk	124.285.000
6	S shpk	57.124.816
7	N shpk	4.604.800
8	I shpk	4.589.509
9	SA	24.404.969
10	IS	6.490.403

b. Për nënkontraktorët e P:

	Nënkontraktorët	TVSH e përjashtuar (shprehur në euro)
1	OT "shpk"	10.383
2	FTS	12.250
3	B & A	12.988
4	BSecurity shpk	31.454
5	Q.S	22.833
7	IA	133.924
8	V	3.600
9	MR	24.964

c. Për nënkontraktorët e SOG:

	Nënkontraktorët	TVSH e përjashtuar (shprehur në lekë)
1	F shpk	600.000
2	Is	1.702.262
3	SA	5.062.596
4	PP	14.403.680
5	FC sha	1.396.350

	Nënkontraktorët	TVSH e përjashtuar (shprehur në euro)
1	K C shpk	24.686
2	AM shpk	10.000
3	A F shpk	42.000

d. Për nënkontraktorët e T sha:

	Nënkontraktorët	TVSH e përjashtuar (shprehur në lekë)
1	L shpk	3.851.540

e. Për nënkontraktorin e CA :

	Nënkontraktorët	TVSH e përjashtuar (shprehur në lekë)
1	AA	1.325.161

f. Për nënkontraktorin e S D:

	Nënkontraktorët	TVSH e përjashtuar (shprehur në euro)
1	K C	6.600

Për sa më sipër është rekomanduar:

a. Nga AKBN në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të mundësohet arkëtimi i shumës prej **316 milionë lekë** duke trajtuar me vëmendje shmangiet e pagesave të TVSH nga nënkontraktorët për shërbime që ne gjykojmë nuk lidheshin dhe nuk mund të përfshiheshin në procese hidrokarbure, kjo e shoqëruar me nxjerrje të përgjegjësive individuale dhe institucionale për shkak të veprimit dhe mos veprimit lidhur me këtë çështje.

Menjëherë

b. Të rivlerësohet TVSH e kërkueshme për përjashtim për shërbimet e këtyre furnitorëve në vijimësi për periudhën deri në 31 dhjetor 2014, ose në pamundësi për këtë periudhë të reflektohet për vitin 2015 dhe në vijim, kjo duke bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Nga auditimi për periudhën 2012 dhe 2013, u konstatua se nga kompania B.P. që operon në fushën e nxjerrjes së naftës ka përdorur Hollues (Diezel 1000 ppm) në operacionet hidrokarbure por pa reflektuar në sasi të totale të naftës së nxjerrë sasinë që përfitohet nga përdorimi i këtij holluesi dhe në këtë mënyrë kanë shkaktuar evazion fiskal për shkak të mos deklarimit që i korrespondon vlerës së sasisë së naftës krudo të nxjerrë pas procesit.

Nga auditimi për periudhën 2012 dhe 2013 u konstatua se nga dy kompanitë SOGDhe T që operojnë në fushën e nxjerrjes së naftës është përdorur Hollues (Diezel 1000 ppm) në operacionet hidrokarbure por edhe në këtë rast nuk kemi reflektim të kësaj sasive holluesi në sasinë e naftës së nxjerrë duke lënë hapësira për evazion të mundshëm fiskal me efekte për buxhetin e shtetit.

Evazoni fiskal në këto raste i shoqëruar dhe me efekte të ndjeshme në Faktorin R, shumëfishon dëmin ekonomik që i vjen shtetit shqiptar nga mungesa e kontrollit, monitorimit dhe mbikëqyrjes së procese hidrokarbure. *Trajtuar më hollësisht në pikën X të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi.*

Për sa më sipër është rekomanduar:

Nga ana e MEI dhe AKBN në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (pasi të bëjë vlerësimin e gjetjeve të këtij raporti dhe analizojë edhe fakte të tjera të lidhura me llogaritjen e efektit ekonomik të këtij veprimi) të merren të gjitha masat dhe të ndiqen rrugët ligjore të duhura për shpërblimin e dëmit të ardhur nga evazoni fiskal i vlerësuar nga ky mision auditimi në rreth **81.7 milion USD** për rastin e B.P. **2.32 milion USD** për SOGDhe **5.48 milion USD** T.

Menjëherë

D. KALLZIM PENAL

Meqenëse gjetjet nga ky mision auditimi janë komplekse, si përta i përket natyrës së tyre administrative ashtu dhe asaj ekonomike, duke pasur parasysh faktin që problematika e konstatuar në lidhje me faktorin “R” është një çështje e shtrirë ndër vite dhe që përfshin njëkohësisht një numër të konsiderueshëm drejtuesish dhe nëpunësish të institucioneve të ndryshme shtetërore, në kushtet e pamundësisë ligjore që KLSH-ja ka në drejtim të auditimit të drejtpërdrejtë të kompanive private që operojnë brenda territorit të Republikës së

Shqipërisë në sektorin e hidrokarbureve çka e ka kufizuar këtë auditim vetëm në shqyrtimin e dokumentacionit të mangët që na është vënë në dispozicion duke nxjerrë si justifikim pretendimin e ruajtjes së konfidencialitetit, nisur nga pengesat e ndryshme artificiale që titullarët e AKBN-së kanë nxjerrë për KLSH-në në kryerjen e këtij auditimi, duke qenë se gjetjet e këtij auditimi evidentojnë ekzistencën e elementëve të shumë veprave penale të kryera nga një sërë nëpunësish dhe ish-nëpunësish të administratës shtetërore, si dhe duke mbajtur parasysh sensibilitetin e ngjarjeve të fundit të ndodhura në Marinëz (ngjarje kjo e paralajmëruar që në Projektraportin e Auditimit të nisur në AKBN, me shkresën e Kryetarit të KLSH me nr. 850/7, datë 09.03.2015) dhe investimin e organit të Prokurorisë në lidhje me këtë ngjarje;

Është rekomanduar:

Përcjelljen për vlerësim të këtij Raporti Përfundimtar Auditimi institucionit të Prokurorisë, i cili në shqyrtim të gjetjeve të konstatuara nga ky auditim të vlerësojë ekzistencën e elementëve të veprave penale të kryera nga drejtues apo nëpunës të AKBN-së duke i ardhur kështu në ndihmë dhe duke i shërbyer hetimit të nisur aktualisht nga Prokuroria në lidhje me ngjarjet e ndodhura në Marinëz.

Bashkëlidhur materialeve të dosjes së auditimit, ti dërgohet organit të Prokurorisë edhe shkresat që vërtetojnë dashjen dhe qëllimin e drejtuesve të AKBN-së dhe Albpetrol-it në drejtim të pengimit të ushtrimit nga KLSH të këtij auditimi.

E. MASA DISIPLINORE

Nisur nga shkeljet e konstatuara në veprimtarinë e nëpunësve e punonjësve të strukturave të MEI dhe AKBN të ngarkuara me monitorimin, mbikëqyrjen e miradministrimin në sektorin hidrokarbur të vendit si dhe nga fakti i ndryshimeve të vazhdueshme të stafit të këtyre strukturave, trajtuar në këtë Raport Përfundimtar Auditimi, ***është rekomanduar:***

Ministri i MEI dhe Drejtori Ekzekutiv i AKBN pasi të shqyrtojë këtë Raport Përfundimtar Auditimi për shkeljet e konstatuara në lidhje me personat e atakuar, të marrë masat disiplinore deri në “Largim nga detyra”; Në veçanti për Drejtorin Ekzekutiv të AKBN z. D.D. Zëvendës Drejtorët Ekzekutiv të AKBN: z. B.M e z. E.S si dhe drejtorët e përgjegjës të sektorëve të strukturave pranë AKBN dhe MEI që operojnë në sektorin hidrokarbur.

Menjëherë

F. MATERIAL PËR ILDKPKI

Nga ana e autoriteteve përgjegjëse, pranë MEI dhe AKBN në bashkëpunim me ILDKPKI të merren masat në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, për evidentimin dhe zgjidhjen e konflikteve të mundshme të interesit për stafin e këtyre dy institucioneve që operojnë në sektorin hidrokarbur.

Menjëherë e vazhdimisht

G. TË TJERA

1. Nisur nga problematikat e konstatuara në auditimet e kryera nga ana e KLSH në MEI, Albpetrol sha. dhe AKBN në përfundim të të cilave nga ana e Kryetarit të KLSH i janë dërguar institucioneve respektive Raportet Përfundimtare të Auditimit bashkë me rekomandimet për përmirësimin e gjendjes (me shkresat, nr. 528/29, datë 26.09.2014 ,drejtuar Ministrit të MEI dhe Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol sha. si dhe shkresa nr. 528/30 datë 27.09.2014 drejtuar administratorit të Albpetrol sha, bazuar këto në Vendimin nr. 528/25, datë 24.09.2014 të Kryetarit të KLSH);

Nisur dhe nga rekomandimet e Kryetarit të KLSH, për sa i përket procedurës së audituar të privatizimit të Albpetrol sha, dërguar me shkresën nr. 478/14 datë 23.12.2013 (bazuar në Vendimin nr. 478/13 datë 23.12.2013 të Kryetarit të KLSH) Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik Tregtisë dhe Sipërmarrjes sot Ministria Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet për përmirësimin e gjendjes) në të cilën në pikën dy të sajë , është rekomanduar e cituar si më poshtë:

*Nisur nga konstatimet e kësaj procedure të audituar, për të siguruar një proces sa më efektiv e të besueshëm në procedurat e privatizimeve strategjike dhe jo vetëm, **është rekomanduar:***

-Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, të realizojnë ndërhyrjet e duhura në aktet ligjore dhe nënligjore, për të përfshirë në formularët e garancive të ofertave dhe të kontratave, si në proceset e privatizimeve dhe në ato të tenderimeve, elementë shtesë që të garantojnë sigurinë e këtij dokumentacioni, duke ndihmuar në mos përsëritjen e rasteve të ngjashme me pasoja negative për buxhetin e shtetit.

*- Duke patur në konsideratë rëndësinë e këtij sektori për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare, në rast të riaktivizimit të kësaj procedure apo dhe në procedura të tilla të ngjashme, autoritetet shtetërore përgjegjëse duhet të sigurohen të përfshijnë në këto procese, me përparësi të lartë dhe ekskluzivitet, aleatë strategjikë të vendit tonë (veçanërisht ato me traditë të konsoliduar në këtë sektor, si SHBA dhe Mbretëria e Bashkuar), si dhe të mundësojnë arritjen e transparencën reale të zotëruesve të kompanive ofertuese pjesëmarrëse në garë (sipas **Vendimit nr. 160 (nr. 478/13 prot.) datë 23.12.2013 të Kryetarit të KLSH**); Duke pasur parasysh aktualitetin çështjes e prioritetet e qeverisjes aktuale në drejtim të privatizimit të Albpetrol sha, me qëllim për të siguruar një proces sa më efektiv e të besueshëm në procedurat e privatizimeve strategjike dhe jo vetëm, **është rekomanduar përsëri:***

1. Ministritë përgjegjëse në këtë procedurë, të pritshme privatizimi strategjik, në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, të kërkojnë nga Kuvendi dhe të realizojnë ndërhyrjet e duhura në aktet ligjore dhe nënligjore, për të përfshirë në formularët e garancive të ofertave dhe të kontratave, si në proceset e privatizimeve dhe në ato të tenderimeve, elementë shtesë që të garantojnë sigurinë e këtij dokumentacioni, duke ndihmuar në mos përsëritjen e rasteve të ngjashme me pasoja negative për buxhetin e shtetit.

Është thelbësore që nga ana e MEI si struktura përgjegjëse, në bazë të nenit 3 të ligjit nr. 7746, datë 28.07.1994 “Për hidrokarburet, kërkimi dhe prodhimi” i ndryshuar, të merren masat në bashkëpunim me institucionet e tjera të shtetit që përpara riaktivizimit të procedurave të privatizimit të Albpetrol sha. të vlerësohen nga ana financiare dhe ekonomike përveç aseteve (inventarit ekonomik) dhe të gjitha depozitimet e hidrokarbureve që ekzistojnë në gjendjen e tyre natyrore në shtresë që Albpetrol sha. ka në administrim (shfrytëzim) me qëllim që minimumi i dyshemesë së vlerës së ankandit të pritshëm të jetë jo më e vogël se sa vlera më e lartë e paraqitur në ankandin e mëparshëm. Për të realizuar këtë vlerësim do të shërbente më së miri një institucion i ngjashëm me Institutin e Naftës (të cilin KLSH e rekomandon në këtë material auditimi si domosdoshmëri për krijim e funksionim) ose deri në krijimin e tij të ngarkohet me këtë detyrë një Komision Ekspertësh të fushës të caktuar nga Kuvendi.

- Duke pasur në konsideratë rëndësinë e këtij sektori për ekonominë e vendit dhe sigurinë kombëtare, në rast të riaktivizimit të kësaj procedure apo dhe në procedura të tilla të

ngjashme, në sektorin hidrokarbur, autoritetet shtetërore përgjegjëse duhet të sigurohen të përfshijnë në këto procese, me përparësi të lartë dhe ekskluzivitet, kompani me potenciale të larta profesionale nga aleatët strategjikë të vendit tonë (veçanërisht ato me traditë të konsoliduar në këtë sektor, si SHBA, Mbretëria e Bashkuar apo Gjermania), si dhe të mundësojnë arritjen e transparencën reale të zotëruesve të kompanive ofertuese pjesëmarrëse në garë.

Menjëherë e vazhdimisht

- Nga ana e Ministrit të MEI, Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol sha. si dhe Administratorit të Albpetrol sha. të merren masat e duhura për të analizuar shkaqet dhe përgjegjësitë për mosrealizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH (me shkresën e Kryetarit të KLSH nr. 528/29, datë 26.09.2014 ,drejtuar MEI, dhe Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol dhe nr. 528/30 datë 27.09.2014 , drejtuar Administratorit të Albpetrol sha, bazuar këto në Vendimin nr. 528/25 datë 24.09.2014 e Kryetarit të KLSH me të cilën janë miratuar e dërguar Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet) si dhe të ndjekë dhe të informojë KLSH për zbatimin e tyre.

Menjëherë

H. TË FUNDIT

1. Një kopje e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Vendimi i Kryetarit të KLSH për evadimin e tij, ti përcillet edhe Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit, Kryetarëve të Grupeve Parlamentare të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike, Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit si dhe Ministrit të Financave (Në zbatim të nenit 32 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” si dhe kërkesës për ruajtjen e konfidencialitetit).

2. Një kopje e këtij Raporti Përfundimtar Auditimi dhe materialeve dokumentare të dosjes së auditimit ti dërgohet institucionit të Prokurorisë së Përgjithshme , për vlerësime të mëtejshme lidhur me përgjegjësinë Penale të zyrtarëve përgjegjës.

3. Të vendoset në shkresën përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit arsyetimi mbi konfliktin e interesat të pretenduar në observimet e AKBN dhe ballafaqimin përmbyllës të organizuar në ambientet e KLSH, në lidhje me ekspertin e aktivizuar në këtë auditim z.S.T.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Muhamed Kavaja, përgjegjës grupi, Valentina Golemi, Xhuljeta Çelaj, Anila Halili, Prof.Dr. Sotir Tego, Prof.as. Sazan Guri, më tej materiali u shqyrtua nga Kryeaudituesi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Departamentit.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT